

---

**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A**

**Data: 19.05.2026**

**PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE MOTORJENERATOR**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** Gjenerator 31122000-7; 44321000-6 Kabllo; Panele kontrolli 31211110-2; Sherbime instalime gjenerator 51111200-5; 45210000-2 Punime ndertimi.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 7,471,690 (shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga

*ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Bazuar në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Bazuar në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: “ 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:* c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës e fondit limit të kontratës është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19%** e vlerës e fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose*

*entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Bazuar në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% e vlerës e fondit limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për motogjeneratorin, panelin automatik i kontrollit (AMF) dhe panelin komutimit (ATS). Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Në neni 40/3/ 8“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 8 përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Autorizimi i prodhuesit/ ose distributorit të autorizuar duhet të paraqitet nga operatori ekonomik, pasi vërteton që prodhuesi/ distributor i autorizuar, autorizojnë operatorin ekonomik të tregtojë produktin e tij në Republikës së Shqipërisë. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallin e kërkuar, origjinale të prodhuara nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallin e kërkuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi atëherë, ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallrat, me garanci e suport teknik.

Nisur nga rëndësia që sigurimi në cilësi, kohë si dhe nisur nga sasia dhe vlera e fondit limit, njësia e prokurimit gjykon se, ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin dhe është në proporcion me objektin e kësaj procedure prokurimi, dhe nuk e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi si dhe nuk e ulin konkurrencën dhe në këtë kuadër.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar për motogjeneratorin, panelin automatik i kontrollit (AMF) dhe panelin komutimit (ATS), ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të tyre, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e mallrave të ofruar me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. ....4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve

ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, të cilat janë të rëndësishme për punën Degen e Doganes Kakavije, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu katalogët/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçenesën profesionale të shoqërisë në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila të përfshijë kategorinë e mëposhtme:

- N.P - 11- A (Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”; si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 pika 1, ku përcakton se: “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” dhe V.K.M Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, ku nën nenin 1 pika 1 përcaktohet se: “1. Qëllimi dhe fusha e veprimit: Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësive që ka subjekti i pajisur me licencë. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht

formës së organizimit të tij. Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje.” Dhe lidhjes 2 dhe 3 të këtij vendimi:

“Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme: **N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike:** Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.”

Kategoria e kërkuara është në në përputhje me zërat e punimeve në preventiv, ku kemi punime elektrime si Instalimin dhe konfigurimin e panelit AMF dhe ATS, lidhjen e kablllove të fuqisë (240mm<sup>2</sup> dhe 150mm<sup>2</sup>) dhe punime civile të ndërtimit, ku përfshihen ndërtimi i bazamentit prej beton-armeje (që duhet të mbajë peshën dhe vibrimet e gjeneratorit 330 kVA), hapjen e kanaleve, thyje dhe bërje mur tulle, suvatimet dhe lyerjen e dhomës, hapje kanali m krah etj.

Kërkesa për kategoritë e licences që duhet të ketë operatori ekonomik pjesmarrës është vendosur në përputhje me vlerën dhe objektin e kësaj procedure prokurimi, punimeve që do të kryhen për realizimin e objektit të prokurimit.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë, si më poshtë

1. Minimalisht 1 (një) Inxhinier Elektrik

Per punojesin e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Diploma e shkollës së lartë
- CV

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

- Minimalisht 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"

Per punojesin e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontrate pune/kontratë bashkëpunimi (të vlefshme).
- Çertifikatën përkatëse (e vlefshme)

- Minimalisht 1 (një) Specialist elektrikist
- Minimalisht 1 (një) Specialist Mekanik

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Shënim:** Kriteri 5 dhe 6 si më sipër konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumentave të kërkuara më sipër ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** Kërkesa 5 dhe 6 si me mësipërme janë bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 40 pika 5 të ndryshuar, ku përcaktohet se: ”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike si dhe brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me preventivin që do të realizohet. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që realizimi i kontratës do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike pasi nuk kemi të bëjmë vetëm me furnizim të motogjenerator, por edhe me vendosjen në punë të tij dhe sistemim të ambientit ku do të vedoset. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” të ndryshuar. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e preventivit si dhe afateve për realizimin e kontrates.

Kërkesa për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” mbështet në ligjin mbështet në ligjin nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar, neni 7 pika 1, 2 dhe 3 ku përcaktohet se “1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion. 2. Në përputhje me pikën 1 të këtij neni: a) punëmarrësi/punëmarrësit i/e ngarkuar nuk mund të cenohen për shkak të veprimtarisë së tij/tyre,

lidhur me mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve profesionale; b) punëmarrësit/punëmarrësve i/u jepet koha e nevojshme për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga ky ligj; c) punëmarrësit/punëmarrësve i/u sigurohen nga punëdhënësi mjetet dhe trajnimi i nevojshëm për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. 3. Punëdhënësi u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke hyrë në marrëdhënie kontraktore me ta, nëse kapacitetet e ndërmarrjes/institucionit janë të pamjaftueshme për të organizuar veprimtari për mbrojtjen dhe parandalimin” dhe neni 10 pika 2 i V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “2. Subjektet për të cilat flitet në pikën 1, gjithashtu duhet të kenë certifikatë që tregon pjesëmarrjen në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private” Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Për të realizuar këtë objekt prokurimi, që përfshin furnizimin dhe instalimin e një gjeneratori me fuqie të lartë (300-330 kVA), nevojitet një ekip i kombinuar specialistësh si më poshtë:

- Minimalisht **1 (një) Inxhinier Elektrik**

Ky është specialisti më i rëndësishëm për këtë preventiv për instalimin dhe konfigurimin e panelit AMF dhe ATS, lidhjen e kabllave të fuqisë (240mm<sup>2</sup> dhe 150mm<sup>2</sup>), programimin e kontrollit në distancë (Ethernet) dhe sinkronizimin e dy linjave të rrjetit me gjeneratorët.

- Minimalisht **1 (një) Specialist elektrikist**

Realizimin e fushës së tokëzimit dhe lidhjen e tyre me sistemin, si dhe shtrirjen e kabllave të togëzimit dhe punime të tjera elektrike sipas preventivit.

- Minimalisht **1 (një) Specialist Mekanik**

Montimin e sistemit të shkarkimit të gazrave djegës dhe sistemit të shkarkimit të ajërit të nxehtë. Kjo kërkon saktësi për të shmangur kthimin e gazeve në dhomë apo mbinxhjen e motorit.

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 45001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në pikën 1 të nenit 44 "Kërkesat

e cilësisë "të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar/vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. Nisur nga natyra e objektit të prokurimit, ku kemi jo vetëm furnizim mallrash por edhe shërbime dhe punime të lidhura me mallrat, si punime elektrike apo ndërtimi është e rëndësishme që operatorët ekonomikë ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbështetur në parimin të sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjësve të tyre.

**ISO 9001** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 45001** është standard ndërkombëtar, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i kontratës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

8.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se afati i garancisë së mallrave objekt prokurimi, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 "Formulari i specifikimeve teknike".

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku përcaktohet se: "4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës." dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, ku përcaktohet se: "8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për

*ekzekutimin me sukses të kontratës.*”. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar në rastin konkret është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t’i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar pëson defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

**Argumentimi.** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjen përkatëse të caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuar, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** *Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:*

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efiçencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Dega e Doganës Kakavijë, si më poshtë:**

**SPECIFIKIMET TEKNIKE:**

<b>Specifikimet Teknike të Gjeneratorit 330 kVA</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Vlera</b>	<b>Shënime</b>
<b>I.</b>	<b>Të përgjithshme</b>			
1.1	Fuqia Bazë (PRP)	kVA	300	Jo me pak se vlera e paraqitur
1.2	Fuqia Emergjentes (LTP)	kVA	330	Jo me pak se vlera e paraqitur
1.3	Fuqia Bazë (PRP)	kW	240	Jo me pak se vlera e paraqitur
1.4	Fuqia Emergjentes (LTP)	kW	280	Jo me pak se vlera e paraqitur
1.5	Tensioni Nominal	Vac	400/230	
1.6	Frekuenca	Hz	50	
1.7	Rryma	A	430	Jo me pak se vlera e paraqitur
1.8	Cos ρ		0.8	Jo me pak se vlera e paraqitur
1.9	Shpejtësia	RPM	1500	
1.10	Mbrojtja me automat		Termomagnetik	I instaluar në shasi
1.11	Nr. poleve të automatit	nr.	4	
1.12	Ndezja		me bateri	
1.13	Sistemi ndihmës	Vdc	24	
1.14	Kapaciteti baterisë	Ah	2 x 120	Jo me pak se vlera e paraqitur

<b>II.</b>	<b>Zhurma dhe dimensionet</b>			
2.2	Super silent		Po	
2.3	Niveli zhurmave @ 7 mt	dB(A)	67	Jo me pak
2.4	Niveli zhurmave @ 1 mt	dB(A)	76	Jo me pak
2.5	Dimensionet (L x W x H)	cm	410 x 150 x 230	Këto dimensione janë orientuese
2.6	Pesha	kg	3630	Këto dimensione janë orientuese
<b>III.</b>	<b>Motori</b>			
3.1	Marka			EU
3.2	Modeli			Kualitet i lartë
3.3	Kontrolluesi shpejtësisë		ECU	ose elektrik
3.4	Radiator		Mekanik	
3.5	Ftohja	tipi	likuid	ujë + 50% antingrirës
3.6	Fuqia neto aktive	kWm	260	Jo me pak se vlera e paraqitur
3.7	Fuqia neto nominale	CV	350	Jo me pak se vlera e paraqitur
3.8	Nr. cikleve	tipi	4-kohesh	
3.9	Injektimi	tipi	direkt	
3.10	Aspirimi	tipi	Turbo	
3.11	Nr. cilindrave	n	5	Jo me pak se vlera e paraqitur
3.12	Vendosja e cilindrave		Linjë	
3.13	Bore	mm	130	Këto dimensione janë orientuese
3.14	Stroke	mm	140	Këto dimensione janë orientuese
3.15	Vëllimi	litra	9.3	Këto dimensione janë orientuese
3.16	Karakteristikat e vajit		15W40	15W40-API/CH-4 ACEA E5-E7
3.17	Kapaciteti vajit	litra	36	Kjo vlerë është orientuese
3.18	Kapaciteti likuidit ftohës	litra	37	Kjo vlerë është orientuese
3.19	Konsumi karburantit në 100% ngarkesë	lt/h	62	Jo më pakë se kjo vlerë
3.20	Konsumi karburantit në 75% ngarkesë	lt/h	47	Jo më pakë se kjo vlerë
3.21	Konsumi karburantit në 75% ngarkesë	lt/h	32	Jo më pakë se kjo vlerë
3.22	Kapaciteti depozitës @ 75% ngarkesë	h	12	Jo më pakë se kjo vlerë
<b>IV.</b>	<b>Alternatori</b>			
4.1	Marka			EU
4.2	Modeli			Kualitet i lartë
4.3	Fuqia bazë	kVA	310	Kjo vlerë është orientuese

4.4	Saktësia e rregullimit të tensionit	±%	1	
4.5	Nr. i Poleve	nr.	4	
4.6	Fazat	nr.	3+N	
4.7	Lidhja standarde e pështjellave		Seria YII	
3.10	Çiftimi rotor/stator		H (Outdoor Temp 40°C)	
3.11	Rendimenti	%	92.9	Jo më pak se vlera e paraqitur
3.12	Xhintimi me motorin		Disk elastik	
3.13	Rryma lidhjes së shkurtër		3 x In	
3.14	Shkalla e mbrotjes	IP	23	
3.15	Sistemi ftohjes		Me vetëftohje	
3.16	Shmangia e sinusoidës	%	<5	
3.17	Eksitimi		urë me dioda	
3.18	Rregullimi		AVR	(Automatic Voltage Regulator)
<b>V.</b>	<b>Paneli automatik i kontrollit (AMF)</b>			
<p>Paneli automati i kontrollit të gjeneratorit dhe rrjetit të jetë i përrë nga një kasetë metalike e lyer me epoxyresinë, ku brenda saj të jenë instaluar të gjitha aksesortët e nevojshëm për ndezjen/fikjen dhe mbrojtjen e gjeneratorit, të tilla si, relet e fuqisë, relet ndërmjetëse, siguresat, automatet, alarmet e jashtme, ushqyesi baterisë, etj.</p>				
5.1	Marka			EU
5.2	Modeli			Kualitet i lartë
5.3	Instalimi			
5.4	Tensioni punës në AC	Vac	220-260	
5.5	Tensioni punës në DC	Vdc	12-24	
5.6	Kominikimi i të dhënave		RS-485 / USB / RS-232	
5.7	Kontrolli në distancë		Ethernet / SNMP	Të jetë i përfshirë
5.8	Rele për kontakte të thata	copë	5	Që të tregojnë statusin e gjeneratorit
5.9	Mateje/kontroll nivel karburanti	%	Po	
5.10	Mateje/kontroll presion vaj	bar	Po	
5.11	Mateje/kontroll temperature uji	°C	Po	
5.12	Mateje/kontroll i tensionit të baterisë	Vdc	Po	
5.13	Mateje/kontroll shpejtësi motori	rpm	Po	
5.14	Mateje/kontroll parametra gjeneratori	V, A, kW, kVA, kVAr	Po	

5.15	Mateje/kontroll parametra rrjeti	V, A, kW, kVA, kVAr	Po	
5.16	Ndezje automatike		Po	
5.17	Ndezje manuale		Po	
5.18	Gjendje pause		Po	
5.19	Butona navigimi në tastier		Po	
5.20	Alarmer njoftimi për të pas kujdes		Po	
5.21	Alarmer mbrojtje me fikje direkte		Po	
<b>VI.</b>	<b>Paneli komutimit (ATS)</b>			
<p>Paneli komutimit të jetë i përbërë nga një kasetë metalike epoxyresine, ku brenda të cilës të jenë instaluar të gjitha aksesorët e nevojshëm për funksionim dhe mbrojtje, të tilla si rele, siguresa, terminale, sinjalizues, diagrama elektrike, etj.</p>				
6.1	Marka			EU
6.2	Modeli			Kualitet i lartë
6.3	Rryma nominale e punës (Ie) @440 Vac	A	630	Jo fuqia e lëshimit / thithjes
6.4	Tipologjia		automat motorizuar	
6.5	Nr. i Poleve	nr.	4	
6.6	Fazat	nr.	3+N	
6.7	Mbrojtje		siguresa ose automat	
6.10	Rele ndërmjetëse		Po	
6.11	Kasetë metalike jashtë shasisë		Po	
6.12	Kontakte ndihmëse 1 NO / 1 NC		Po	
6.13	Qëndrueshmëria e kycje/ckycjeve	cikle/h	300	Jo më pak se vlera e paraqitur
6.14	Qëndrueshmëria ndaj impulseve të tensionit	kV	8	Jo më pak se vlera e paraqitur
6.15	Nr. cikleve mekanike	cikle	5,000,000	Jo më pak se vlera e paraqitur
6.16	Dimensionet	cm	60 x 50 x 160	
<b>VII.</b>	<b>Sistemi kabllimit</b>			
<p>Kabllo elektrik do të bëjnë të mundur lidhjen e energjisë elektrike nga dalja e matësit të energjisë elektrike në panel ATS. Nga gjeneratori në panel ATS dhe daljen e panelit ATS deri tek paneli kryesor i ngarkesës. Në të gjitha segmentet ku kabëli do të kalojë në ajër, kabëlli do të mbështetet në kanalina metalike. Në ato segmente ku kabëlli është në tokë kabëlli do të futet në tub kurregato.</p>				
7.1	Materiali përcjellësit		Bakër	
7.2	Seksioni përcjellësit për 3 F + N	mm <sup>2</sup>	240	
7.3	Përcjellësi tokëzimit	mm <sup>2</sup>	120	

7.4	Sistem tokëzimi (elektroda Cu, 2M, 3-6 copë, përcjellës i zhveshur, 50 mm <sup>2</sup> , morseta, etj.)		po	
7.5	Instalim në kanalina të zinguar		Po	
7.6	Instalim në tuba kurregato		po	
7.7	Sistem i ndricimit emergjent		po	
7.8	Terminale me kapikorda Cu/Cu		po	
<b>VIII. Sistemi i Shkarkimit</b>				
Duke qënë se gjeneratori do të punojë në ambient të mbyllur, është mëse e nevojshme instalimi i sistemit të shkarkimit të gazrave të djegies dhe ajrit të nxehtë. Sistemi i shkarkimit të jetë me tuba celiku ku diametri i tubit duhet të jetë të paktën 20% më i madhë se tubi i shkarkimit të vetë gjeneratorit. Lidhja e tubit të celikut me tubin e marmitës së gjeneratorit të bëhet me tub fleksibël. Sistemi i shkarkimit të jarit të nxehtë të ndërtohet me kanale ajri llamarinë zingato. Lidhja e gjeneratorit me kanalin e ajrit të bëhet me material fleksibël të tillë si gomë, e cila të jetë e qëndrueshme ndaj vibrimeve.				
8.1	Shkarkimi i gazrave të djegies		po	
8.2	Materiali i tubave të gazrave të djegies		Çelik	
8.3	Shkarkimi i ajrit të nxehtë		po	
8.4	Materiali i kanaleve të ajrit		Llamarinë zingato	

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Objekt i kontratës do të jetë furnizimi/ vendosja dhe kryerja e shërbimeve dhe punimeve që lidhen me vendosjen në punë të motorgjeneratorin, hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Dega e Doganës Kakavijë, si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Njësia
1	Panel AMF, përfshirë të gjitha aksesorët e nevojshëm me kontroll, identik si i gjeneratorit dhe me kontroll në distancë (ethernet). Ku të përfshien, sensorët, temperature, presion vaji, nivel naftë, relet e fuqisë, ushqysi i baterisë, etj.	set
2	F.V gjenerator set 330 kVA LPR dhe 300 kVA PRP, diesel, 1500 RPM, automatik (AMF). Super silent	set
3	Panel komutimi ATS 630 A, 4P, për dy gjeneratorë, dhe dy linja rrjeti me derë xhami (sipas skemës elektrike)	set
4	F.V kabllo Cu, 1 x 240 mm <sup>2</sup> , iz. PVC, 1 kV	ml
5	F.V kabllo Cu, 1 x 150 mm <sup>2</sup> , iz. PVC, 1 kV	ml
6	F.V kabllo Cu, 1 x 120 mm <sup>2</sup> , për tokëzim, iz. PVC, 1 kV	ml
7	F.V kanalina metalike të zinguar dhe birëzuara, me të gjitha aksesorët	ml

8	F.V tub PVC me spirale $\varnothing 110 \text{ mm}^2$	ml
9	F.V sistem tokëzimi me 6 elektroda Cu, 2 m, përcjellës i zhveshur Cu S-50 $\text{mm}^2$ , morseta, etj.	set
10	Hapje kanali me krah deri në 50 cm thellësi për kalimin e kabëllit të tokëzimit	$\text{m}^3$
11	F.V sistem shkarkim gazrave të djegies	ml
12	F.V sistem shkarkim të ajrit të nxehtë	ml
13	F.V terminale TU 1 x (120 - 240) $\text{mm}^2$	set
14	Punime civile (thyerje dhe berje mure tulle, me suvatim dhe bojatisje)	$\text{m}^2$
15	Lyerje e mureve të dhomës me bojë plastike	$\text{m}^2$
16	Bërje bazamenti beton arme, me dimensione 450 x 200 x 15 cm	copë
17	Punime elektrike sistemuese në panelet ekzistuese	copë

Bashkëlidhur DST do të jetë “SKEMA ELEKTRIKE”.

Garancia e Motorgjeneratorit: 2 (dy) vjet, duke filluar nga data e furnizim/vendosjes.

Vendi i dorëzimit: Furnizim/Vendosja e Motorgjeneratorit do të jetë në Degën Doganore Kakavijë.

Për ngarkimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik, njësia e prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin.

## **NJESIA E PROKURIMIT**